



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 03.08.2024

Nr: 163

Ora: 12:27

VENDIM

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË “BIRN ALBANIA”, PËR AKREDITIMIN E VËZHguesVE PËR  
VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR Kryetar TË Bashkisë Himarë TË DATËS 4 GUSHT  
2024

Sot në datën 03.08.2024, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesën e:

**KËRKUES:** “BIRN Albania”, me adresë në Rruga Nikolla Jorga 8/8;

**OBJEKTI:** Kërkohet akreditimi si vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve te pjeshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”. Vendimi nr. 19, datë 27.01.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”.

Data: 03.08.2024  
Ora: 12:27

Nr: 163



Për miratimin e vëzhguesve, për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjeshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024

## V Ë R E J:

“BIRN Albania” i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 1 vëzhguesve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre.

Kërkesa është paraqitur në datën 02.08.2024.

“BIRN Albania”, në respektim të nenit 6, pika 2 të Kodit Zgjedhor është një organizatë që gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje.

Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor.

Dokumentacioni shoqëruar i kërkesës është në përputhje me përcaktimet e nenit 6, pika 4 e vijues të Kodit Zgjedhor

## PËR KËTO ARSYE:

Si dhe në mbështetje të neneve 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 19, datë 27.01.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”,

## V E N D O S :

1. Akreditimin e 1 vëzhguesve të “BIRN Albania” për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 1 (një) dite nga shpallja e tij në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: 03.08.2024      Nr: 163  
Ora: 12:27



Për miratimin e vëzhguesve, për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024

Aneksi 1: Lista e Vëzhguesve te Miratuar te “BIRN Albania”

	<b>Emri</b>	<b>Mbiemri</b>	<b>Mandati</b>	<b>Seriali</b>	<b>Zona e vëzhgimit</b>
<b>1.</b>	Fjoralba	Sinoruka	Afatgjate	000097	Ne te gjithe vendin

Data: 03.08.2024  
Ora: 12:27

Nr: 163



Për miratimin e vëzhguesve, për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024